



*(Mos)*Planifikimi i Prokurimit

Raport i monitorimit të 20 komunave lidhur me planifikimin
përfundimtar të prokurimit 2023

(Mos)Planifikimi i Prokurimit

Prishtinë, nëntor 2023

Autore: Leorentë Alija

Redaktore: Albulena Nrecaj

Ekipi hulumtues: Valmir Ilazi, Ebru Zborça, Arber Kabashi

Të gjitha të drejtat e këtij botimi i takojnë organizatës Iniciativës për Progres – INPO. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të printohet, distribuohet, kopjohet, shumëfishohet në çfarëdo forme apo mënyrë, elektronike ose të shtypur, pa pajtimin paraprak të Organizatës Iniciativa për Progres. Të drejtat dhe prona intelektuale e këtij botimi mbrohen me Ligjin nr.04/L-065 për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta të Republikës së Kosovës.

Përmbajtja e këtij publikimi është përgjegjësi ekskluzive e Iniciativës për Progres – INPO dhe nuk pasqyron pikëpamjet e Byrosë për Çështjet Ndërkombëtare të Narkotikëve dhe Zbatimit të Ligjit (INL) - Departamenti i Shtetit Amerikan.

Përkrahur nga:



Përmbajtja

1. Lista e shkurtesave	5
2. Përmbledhje ekzekutive	6
3. Metodologjia	8
4. Baza ligjore për planifikim të prokurimit	9
5. Shkaqet dhe pasojat e planifikimit të dobët të prokurimit.....	10
6. Planifikimi i prokurimit për vitin 2023	11
7. Zbatimi i planit përfundimtar të prokurimit për vitin 2023 në tetëmbëdhjetë (18) komuna....	12
7.1.Zbatimi i planit të prokurimit tek aktivitetet për furnizime	12
7.2. Zbatimi i planit të prokurimit tek aktivitetet për shërbime dhe për punë.....	14
8. Tejkalmi i vlerës së parashikuar të planit të prokurimit dhe përqindja e buxhetit të shpenzuar	16
8.1. Furnizimet.....	16
8.2. Shërbimet	18
8.3 Punë.....	19
9. Institucionet përgjegjëse për zbatimin e planifikimin e prokurimit	21
9.1. Autoriteti Kontraktues.....	21
9.2. Agjencia Qendrore e Prokurimit	22
9.3. Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik.....	23
10. Të gjeturat dhe ndikimi i INPO-s rreth planifikimit të prokurimit (2020-2022)	24
11. Gjetjet kryesore	27
12. Rekomandimet	29
13.. <i>Aneks I</i> : Pesë (5) aktivitetet e para për furnizime, shërbime dhe punë në tetëmbëdhjetë (18) komuna...30	

I. Lista e shkurtesave

AK	Autoritet Kontraktues
AQP	Agjencia Qendrore e Prokurimit
DNKDF	Deklarata e Nevojave dhe Përcaktimi i Disponueshmërisë së Fondeve
INPO	Iniciativa për Progres
KRPP	Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik
IKAP	Instituti i Kosovës për Administratë Publike
LPP	Ligji për Prokurimin Publik
OE	Operator Ekonomik
RrPP	Rregullat për Prokurim Publik
ZKA	Zyrtari Kryesor Administrativ

2. Përmbledhje ekzekutive

Planifikimi vjetor i prokurimit si hapi i parë i procesit të prokurimit është tejet i rëndësishëm sa i përket ngritjes së efikasitetit të planifikimit të mirëfilltë të shpenzimeve të komunave. “*Plani i prokurimit është i lidhur me planin strategjik të autoritetit kontraktues*”, kështu thonë raportet e OECD/SIGMAS-s sa i përket prokurimit publik dhe zbatueshmërisë së tij në praktikë. Kësisoj, i njëjti duhet të jetë i hartuar konform legjislacionit primar dhe sekondar i cili rregullon në mënyrë shprehimore këtë obligim ligjor dhe procedural. Për më tepër, duhet të jetë në harmoni të plotë me të gjitha dokumentet e tjera strategjike në atë mënyrë që i njëjti të përmbush objektivat e autoritetit kontraktues.

Qëllimi i këtij raporti është të vlerësoj planifikimin vjetor të prokurimit në nivelin lokal bazuar në indikatorë ligjorë dhe praktik të monitorimit duke evidentuar gjetjet dhe dobësitë e planifikimit vjetor të prokurimit në komuna.

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se përjashtuar Komunën e Klinës, komunat tjera nuk i paraqesin të gjitha detajet formale të kërkuara në planin përfundimtar të prokurimit. Përveç mos respektimit të planit të prokurimit në aspektin formal, edhe për ato aktivitete që janë të planifikuara autoritetet kontraktuese nuk iu përmbahen planifikimeve të sasive, njësive apo vlerës së parashikuar të kontratave gjatë përgatitjes së inicimit të aktivitetit të prokurimit. INPO ka gjetur nga nëntëdhjetë (90) aktivitetet e monitoruara për furnizim vetëm gjashtëdhjetë e shtatë (67) prej tyre janë të parapara në planin e prokurimit, gjersa vetëm një (1) aktivitet i inicuar për furnizim në komunën e Glllogocit i ka detajet e njëjta si në plan të prokurimit.

Nga nëntëdhjetë (90) aktivitetet e monitoruara për shërbime, INPO vetëm gjashtëdhjetë e tre (63) prej tyre i ka identifikuar planin përfundimtar të prokurimit, ndërsa, nga nëntëdhjetë (90) aktivitetet për punë, vetëm shtatëdhjetë e tre (73) aktivitete janë iniciuar sipas planit të prokurimit, pjesa tjetër nuk figuron në planin e hartuar nga AK-të.

Hulumtimi vë në pah se një numër i konsiderueshëm i komunave kanë tejkalluar buxhetin e planifikuar për furnizime, shërbime dhe punë. Ndërsa, pjesa tjetër e komunave nuk kanë arritur ta shpenzojnë as gjysmën e buxhetit për kategoritë e lartëcekura.

Të gjeturat e monitorimit tregojnë se deri më tani KRPP nuk ka në fokus monitorimin e planit të prokurimit apo aspektet e planifikimit të një aktiviteti të prokurimit, pavarësisht se të metat e një aktiviteti të prokurimit në fazën tenderuese dhe pas saj, janë rezultat i një planifikimi të dobët apo jo adekuat. Kontributi i KRPP-së në mbikqyrjen e planifikimit të prokurimit do të jepte rezultate në Autoritete Kontraktuese. Po ashtu, KRPP së bashku me IKAP duhet të fokusohen në dizajnimin e një pakete të trajnimeve të aavancuar në fushën e planifikimit të prokurimit dhe atij buxhetor në Komuna

Rekomandohet që komunat të hartojnë planifikimin e prokurimit në bazë të kërkesave ligjore, respektivisht me detajet e kërkuara nga Formulari B01, si dhe këto detaje të mos ndryshojnë gjatë inicimit të aktivitetit të prokurimit.

Autoritetet kontraktuese të sigurohen se planin e prokurimit ta kenë në përputhje me nevojat dhe kapacitetet buxhetore të tyre, nëse kjo nuk merret parasysh atëherë plani është vështirë i zbatueshëm.

Njësitë kërkuese dhe ZPP-të ta kenë të qartë se vendosja e artikullit, sasisë dhe njësisë tek aktivitetet për furnizim është obligim ligjor, dhe mos vendosja e tyre përveç që është mos zbatim i ligjit, në të njëjtën kohë planifikimin e prokurimit të komunës e bënë të paqëndrueshëm.

3. Metodologjia

INPO me qëllim që të hartoj një raport përmbajtësor dhe në përputhje me objektivat e projektit ka përdorur metodologji të kombinuar të hulumtimit. Objekt i hulumtimit është planifikimi i prokurimit të komunave për vitin 2023. Hulumtimi është i shtrirë në tetëmbëdhjetë (18) komuna, përkatësisht në komunat: Deçan, Dragash, Ferizaj, Glogoc, Gjakovë, Gjilan, Kaçanik, Kamenicë, Klinë, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Rahovec, Suharekë, Shtime, Viti dhe Vushtrri. Për shkak të mungesës së komunikimit me komunat veriore, respektivisht Komuna e Leposaviqit dhe Mitrovicës së Veriut, INPO nuk ka mundur të shtrijë monitorimin e planifikimit të prokurimit në këtë pjesë, përkundër që të njejtat janë fokus i monitorimit. Për më tepër, këto dy (2) komuna nuk e kanë hartuar një plan të tillë.

Fillimisht janë shkarkuar nga platforma e-prokurimi planet përfundimtare të prokurimit për vitin 2023 për secilën komunë, ku është analizuar se këto plane a i përmbushin kriteret formale ligjore, respektivisht a janë këto plane të plotësuara konform kërkesave të LPP-së dhe Formularit B01 të aprovuar nga KRPP¹.

Hulumtimi ka vazhduar me përzgjedhjen e pesë (5) aktiviteteve të para për furnizim, shërbime dhe punë që i kanë iniciuar AK-të gjatë vitit 2023, këto aktivitete të iniciuara fillimisht janë analizuar se a janë të planifikuara në planin përfundimtar të prokurimit. Pastaj, është analizuar se tek aktivitetet për furnizim a janë sasinë njësitë dhe artikujt e njëjtë si në plan ashtu edhe gjatë inicimit. Pas kësaj është analizuar ajo se aktivitetet e selektuara për furnizim, shërbime dhe punë a kanë vlerë të përafërt të parashikuar si në plan ashtu edhe gjatë inicimit.

Gjithashtu, në këtë raport pjesë e hulumtimit janë të gjitha planet e prokurimit ku janë pasqyruar komunat të cilat kanë tejkalluar vlerën e parashikuar për aktivitetet për furnizim, shërbim dhe punë dhe përqindja e buxhetit të shpenzuar për komunat të cilat nuk e kanë tejkalluar vlerën e parashikuar për këto kategori deri më 31.08.2023. Për Komunën e Leposaviqit dhe Mitrovicës së Veriut nuk ka të dhëna.

Në kuadër të këtij raporti janë trajtuar problemet endemike në planifikimin e prokurimit publik dhe ndër të tjerash janë paraqitur rezultatet dhe gjetjet e INPO-s në tre vitet e fundit për sa i përket monitorimit të planit të prokurimit.

Drafti i këtij raporti është dërguar tek të gjitha komunat e monitoruara për komente eventuale. Komentet e dhëna nga komunat janë pjesë e këtij raporti.

¹ Shih platformën elektronike e prokurimit, e qasshme në: <https://e-prokurimi.rks.gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx>, gjithashtu shih Formularin B01, i qasshëm në: <https://e-prokurimi.rks.gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=233>.

4. Baza ligjore për planifikim të prokurimit

Planifikimi i prokurimit është proces ligjor dhe procedural i cili derivon nga Ligji për Prokurim Publik dhe Rregullat për Prokurim Publik. Kjo nënkupton se planifikimi i prokurimit duhet të hartohet bazuar në nevoja reale të qytetarëve dhe në kapacitetin buxhetor të AK-së, plan ky i cili planifikon në detaje të gjitha aktivitetet për furnizime, shërbime dhe punë të cilat AK planifikon t'i inicoj gjatë vitit përkatës. Në fakt, Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik, ka hartuar Formularin B01² përmes së cilit AK duhet të përmbushin këtë obligim ligjor duke paraqitur detajet e hollësishme siç janë titulli, sasitë, njësit, artikujt dhe vlerën e parashikuar për aktivitetet të cilat do ti inicoj përgjatë dymbëdhjetë (12) muajve.

Ligji Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, fillimisht parasheh një planifikim fillestar të prokurimit publik, duke kërkuar kështu që *“Jo më pak se tridhjetë (30) ditë para fillimit të çdo viti fiskal, secili autoritet kontraktues duhet të përgatisë, planifikimin paraprak të prokurimit, dhe në rast të një autoriteti publik apo një ndërmarrje publike duhet të dorëzoj me shkrim te Zyrtari Kryesor Administrativ i Autoritetit Kontraktues, në të cilat identifikohen me detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët, që autoriteti kontraktues parasheh t'i prokurojë gjatë vitit fiskal në fjalë”*³. Pra, bëhet fjalë për një planifikim paraprak i cili mund të ndryshohet dhe plotësohet para se të marrë formën përfundimtare.

Tutje, secili AK *“Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas shpalljes së legjislacionit mbi përvetësimet për një vit fiskal, çdo autoritet kontraktues do të përgatisë, në rast të një autoriteti publik apo një ndërmarrje publike duhet t'i dorëzojë AQP-së, një planifikim përfundimtar me shkrim që i identifikon me detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët që autoriteti kontraktues synon ti prokurojë gjatë vitit të tillë fiskal”*⁴. Nga kjo dispozitë kuptohet që planifikimi i prokurimit duhet të hartohet në detaje të arsyeshme, respektivisht duhet të përmbaj detajet e nevojshme lidhur me planifikimin e aktivitetit të caktuar.

Përveç ligjit, edhe Rregullat përmendin planifikimin e prokurimit si hapin e parë të prokurimit publik. Rregullat definojnë qartë se planifikimi i prokurimit është hapi i parë në procesin e prokurimit duke dhënë udhëzime lidhur me dobitë e një planifikimi të mirë dhe pasojat fatale për AK-të kur bëjnë një planifikim të dobët ose në kundërshtim me nevojat e AK-së.⁵ Pra, përveç obligimit ligjor, planifikimi i prokurimit është i domosdoshëm në mënyrë që AK të mos përballen me situata të pa parashikueshme gjatë udhëheqjes së aktiviteve të prokurimit.

² Shih formularin B01, i qasshëm në <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=233>

³ Neni 8, paragrafi 1, i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, me plotësim ndryshimin e Ligjit Nr. 05/L-068, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>.

⁴ Po aty, neni 8, paragrafi 2.

⁵ Shih gjithashtu RrPP, neni 5, i qasshëm në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/Rregullore%20Nr.001_2022%20p%C3%ABr%20prokurimin%20publik.pdf

5. Shkaqet dhe pasojat e planifikimit të dobët të prokurimit

Planifikimi i mirëfilltë i prokurimit mundëson efikasitetin dhe efektivitetin e prokurimit të një autoriteti kontraktues duke ndikuar direkt në arritjen e planeve strategjike të autoritetit kontraktues. Dështimi për të planifikuar prokurimin rritë rreziqet e kompromitimit apo dështimit të hapave të tjerë të prokurimit, të cilat pasqyrohen edhe në menaxhimin e kontratës, respektivisht implementimit të saj.

Kryetari i KRPP-së në Kosovë, z. Osman Vishaj thotë se “të gjitha parregullësitë dhe keqpërdorimet që na shfaqen në aktivitete të prokurimit, shkaktarë e kanë planifikimin e dobët apo jo adekuat të prokurimit. “Planifikimi është hallka më e dobët, që shpesh është e qëllimishme”.⁶

Sipas SIGMA-s, pasojat e mos planifikimit të prokurimit siç: janë shkëputja në mes të prokurimit dhe planeve strategjike të autoritetit kontraktues, mungesë të bashkëpunimit të zyrës së prokurimit dhe departamenteve të tjera siç është ai i financave, mosnjohja e tregut dhe potencialit të operatorëve ekonomikë, vështirësitë për të realizuar suksesshëm prokurimin, dështimi për të identifikuar prokurimet e përbashkëta të cilat nuk optimizojnë procedurat dhe humbin vlerën e parasë.⁷

Planifikimi i prokurimit nuk është një proces i cili mund të kryhet brenda një dite dhe nuk mund të realizohet kontributi dhe përfshirja e të gjitha drejtorive, departamenteve apo njësisve të autoritetit kontraktues. Zyra e prokurimit ka përgjegjësinë e nisjes së procesit dhe dizajnimin të metodologjisë së planifikimit, por është jetike që palët e tjera të përfshihen në këtë proces.⁸

Në komunat e Kosovës, INPO vlerëson se planifikimi i prokurimit qalon si për nga aspekti i përfshirjes dhe angazhimit të palëve të interesit në proces dhe po ashtu edhe për nga efikasiteti dhe efektiviteti i planifikimit. Komunat nuk e kanë të qartë se përgjegjësi e kujt është planifikimi i prokurimit. Gjysma e komunave të monitoruara mendojnë se planifikimi i prokurimit bëhet nga njësitë kërkuese në bashkëpunim me zyrën e prokurimit, përdërisa gjysma tjetër mendon se planifikimi është vetëm përgjegjësi e zyrës së prokurimit.⁹ Sipas INPO-s mbi gjysma e zyrtarëve përgjegjës të prokurimit të komunave të fokusit, mendojnë se planifikimi i prokurimit i përmbushë pjesërisht nevojat e komunës, pasi që nuk mund të parashikohen me saktësi nevojat dhe kërkesat.¹⁰

INPO vlerëson se për shkak të mos definimit adekuat të objektivave dhe nevojave të AK-së mungon edhe analiza e tregut gjatë apo para fazës së planifikimit, e cila i mundëson AK-së njohjen

⁶ **Shënim:** Kjo fjali është shkëputur nga fjalimi i Kryetarit të KRPP-së, z. Osman Vishaj si panelist, në tryezën e INPO-s me titull: “Shpenzimi i parasë publike përmes Prokurimit Publik”, të mbajtur më 07 nëntor 2023.

⁷ Manuali i Trajnimit të Prokurimit Publik SIGMA, Moduli C, i përditësuar më 2015, i qashshëm në <https://sigmaweb.org/publications/Module-C-%202015-clean.pdf>

⁸ Neni 5, paragrafi 5.10, i Rregullores 001/2022, për Prokurimin Publik, e qashshme në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/Rregullore%20Nr.001_2022%20p%C3%ABr%20prokurimin%20publik.pdf

⁹ Raporti “Planifikimi i Prokurimit” – Raport i Monitorimit të njëzet komunave lidhur me planifikimin e prokurimit për vitin 2022, publikuar nga INPO, i qashshëm në: <https://inpo-ks.org/wp-content/uploads/2022/12/Raport-Planifikimi-i-Prokurimit-2022.pdf>

¹⁰ Ibid.

me strukturën e tregut, kapacitetet dhe aftësitë e operatorëve ekonomik, trendet e çmimeve dhe aspektet e tjera të tregut. Gjatë planifikimit të prokurimit, komunat kryesisht bazohen në kontratat paraprake të lëndeve të njëjta të prokurimit. Kështu, shumë prokurime janë anuluar si rezultat i ofertave të shtrenjta për shkak të ngritjes së çmimeve si rezultat inflacionit dhe mungesës së analizimit të tregut nga ana e komunave.

6. Planifikimi i prokurimit për vitin 2023

AK duke respektuar Formularin B01 janë të obliguara që të hartojnë planifikimin përfundimtar të prokurimit dhe mbi bazën e këtij planifikimi i cili rrjedhimisht duhet të jetë edhe publik, AK inicojnë procedurat e prokurimit.¹¹

Formulari B01 ka kërkesa dhe detaje të ndryshme varësisht se a planifikohen aktivitete për furnizim, shërbime apo punë. Në rast të planifikimit të aktiviteteve për furnizime, Formulari B01 kërkon që të jepen këto informata: Titulli i aktivitetit, artikulli, njësia matëse, sasia e përafërt vjetore, çmimi për njësi, vlera e parashikuar e kontratës dhe data e planifikuar e fillimit të procedurave të prokurimit. Në rast të planifikimit të aktivitetit për shërbime dhe punë, nevojiten këto të dhëna: Titulli i aktivitetit, vlera e parashikuar e kontratës dhe data e planifikuar e fillimit të prokurimit¹².

INPO ka analizuar se a i përmbajnë këto kërkesa dhe detaje formale aktivitetet e planifikuara nga tetëmbëdhjetë (18) komunat e Republikës së Kosovës. Të dhënat i gjeni në tabelën më poshtë.

Respektimi i Formularit B01 – Planifikimi i Prokurimit ¹³										
Nr.	Komuna	Furnizime			Shërbime			Punë		
		Po	Jo	Pjesërisht	Po	Jo	Pjesërisht	Po	Jo	Pjesërisht
1.	Deçan			√	√			√		
2.	Dragash			√	√			√		
3.	Ferizaj			√	√			√		
4.	Glllogoc			√	√			√		
5.	Gjakovë			√	√			√		
6.	Gjilan			√	√			√		
7.	Kaçanik			√	√			√		
8.	Kamenicë			√	√			√		
9.	Klinë	√			√			√		
10.	Pejë			√	√			√		
11.	Podujevë			√	√			√		
12.	Prishtinë			√	√			√		
13.	Prizren			√	√			√		
14.	Rahovec			√	√			√		
15.	Suharekë			√	√			√		

¹¹ Për më shumë shih Formularin B01, Planifikimi i Prokurimit, i qasshëm në: <https://e-prokurimi.rks.gov.net/HOME/ClanakItemNew.aspx?id=233>.

¹² Po aty, Formulari B01.

¹³ **Burimi:** Planet përfundimtare të prokurimit për vitin 2023.

16.	Shtime			√	√			√		
17.	Viti			√	√			√		
18.	Vushtrri			√	√			√		
Gjithsej		1	0	17	18	0	0	18	0	0

Tabela 1: Respektimi i Formularit B01 – Planifikimi i Prokurimit.

Nga të dhënat në tabelën më lartë rezulton se vetëm Komuna e Klinës i përmban të gjitha të dhënat e nevojshme në aspekt formal të kërkuara nga Formulari B01. Ndërsa, komunat e tjera këto të dhëna i kanë në përputhje me kërkesat e Formularit B01 vetëm sa u përket aktiviteteve për shërbime dhe punë, ndërsa sa u përket aktiviteteve të planifikuara për furnizim të dhënat i përmbajnë në mënyrë të pjesshme. Faktori kryesor se pse të dhënat janë të pjesshme, është fakti se këto aktivitete nuk përmbajnë artikujt, sasinë apo njësitë, apo edhe nëse përmbajnë ato janë vetëm “shabllone” të cilat shërbejnë vetëm sa për ta plotësuar planin e prokurimit. Mos përmbajtja e këtyre të dhënave përveç se është tregues se AK-të nuk bëjnë një planifikim të detajuar, në të njëjtën kohë lënë mundësi që gjatë inicimit, aktivitetet të jenë në kundërshtim me planin e prokurimit.

7. Zbatimi i planit përfundimtar të prokurimit për vitin 2023 në tetëmbëdhjetë (18) komuna

INPO në mënyrë sistematike monitoron planifikimin e prokurimit në tetëmbëdhjetë (18) komunat e Republikës së Kosovës dhe zbatimin e tyre në praktikë, rrjedhimisht INPO në raportet e veta vazhdimisht ka paraqitur shklejet e AK - ve për sa i përket aspektit formal dhe procedural të planit të prokurimit. Për nga aspekti formal nënkupton mosrespektimin e vendosjes së gjitha informatave të cilat kërkohen sipas Formularit B01, ndërsa për nga aspekti procedural nënkupton mos implementimi i planit të prokurimit në praktik apo më saktë inicimi i aktiviteteve të prokurimit të cilat dallojnë nga plani i prokurimit apo edhe në rastet kur inicimi i aktiviteteve të prokurimit të cilat fare nuk janë të parapara në plan të prokurimit.

INPO edhe këtë vit ka monitoruar pesë (5) aktivitetet e para për furnizime, shërbime dhe punë, të cilat AK-të i kanë iniciuar në vitin 2023, duke analizuar dhe krahasuar se të njëjtat fillimisht a janë të planifikuara, dhe nëse janë të planifikuara detajet e paraqitura gjatë inicimit a përputhen me atë se çfarë është planifikuar me plan përfundimtar të prokurimit. Gjithashtu, INPO ka monitoruar edhe aktivitetet të cilat janë iniciuar e që rrjedhimisht kanë qenë të paplanifikuara e që vlera e tyre në disa raste është milionëshe.

7.1. Zbatimi i planit të prokurimit tek aktivitetet për furnizime

Ashtu siç u theksua më lartë, aktivitetet për furnizim bëjnë pjesë në aktivitetet për të cilat në Formularin B01 kërkohen detaje më të shumta, nëse krahasohet me aktivitetet e planifikuara për shërbime dhe punë. Secili aktivitet i planifikuar për furnizime duhet të ketë informata mbi titullin e aktivitetit, artikullin, njësinë matëse, sasinë e përafërt vjetore, çmimin për njësi, vlerën e parashikuar të kontratës dhe datën e planifikuar të fillimit të procedurave të prokurimit. INPO ka monitoruar atë se aktivitetet e iniciuara a janë në përputhje me atë çfarë është planifikuar me plan përfundimtar të prokurimit.

Për këtë qëllim janë hulumtuar pesë (5) aktivitetet e para për furnizim të iniciuara nga secila komunë gjatë vitit 2023, respektivisht secili nga pesë (5) aktivitetet është analizuar fillimisht a mund të identifikohet në planin përfundimtar të prokurimit për vitin 2023 dhe nëse po, atëherë detajet a janë të njëjta si në planifikim të prokurimit.

Në tabelën më poshtë janë paraqitur këto të dhëna për tetëmbëdhjetë (18) komuna.

Përputhja e pesë (5) aktiviteteve për furnizim me planin përfundimtar të prokurimit ¹⁴													
Nr.	Komuna	Planifikimi ¹⁵					Përputhja me detajet e paraqitura në plan të prokurimit ¹⁶						
		1	2	3	4	5	Po	Jo	Pjesërisht				
1.	Deçan	✓	x	x	✓	x	0	1	1				
2.	Dragash	x	x	x	x	✓	0	1	0				
3.	Ferizaj	✓	✓	✓	✓	✓	0	1	4				
4.	Glllogoc	✓	✓	x	✓	x	1	0	2				
5.	Gjakovë	✓	✓	✓	✓	✓	0	3	2				
6.	Gjilan	✓	✓	✓	✓	✓	0	3	2				
7.	Kaçanik	x	✓	x	x	x	0	1	0				
8.	Kamenicë	✓	✓	x	✓	✓	0	1	3				
9.	Klinë	x	x	x	x	x	0	0	0				
10.	Pejë	✓	✓	✓	✓	✓	0	5	0				
11.	Podujevë	✓	✓	✓	✓	✓	0	1	4				
12.	Prishtinë	✓	✓	✓	✓	✓	0	3	2				
13.	Prizren	✓	✓	✓	✓	✓	0	4	1				
14.	Rahovec	✓	✓	✓	✓	✓	0	4	1				
15.	Suharekë	✓	x	x	x	✓	0	1	1				
16.	Shtime	✓	✓	✓	✓	x	0	1	3				
17.	Viti	✓	✓	✓	✓	✓	0	1	4				
18.	Vushtrri	✓	✓	✓	✓	✓	0	4	1				
Gjithsej		<table border="1"> <tr><td>67</td><td>23</td></tr> <tr><td>✓</td><td>x</td></tr> </table>					67	23	✓	x	1 nga 67	35 nga 67	31 nga 67
67	23												
✓	x												

Tabela 2: Përputhja e pesë (5) aktiviteteve për furnizim me planin përfundimtar të prokurimit.

Nga të dhënat në tabelë vërtetohet se nga pesë (5) aktivitetet e para për furnizim në tetëmbëdhjetë (18) komuna, një pjesë e konsiderueshme këtyre aktiviteteve nuk kanë qenë fare të planifikuara me plan të prokurimit. Nga nëntëdhjetë (90) aktivitetet e monitoruara, njëzet e tre (23) prej tyre janë iniciuar pa qenë fare të planifikuara, ndërsa gjashtëdhjetë e shtatë (67) prej tyre kanë qenë aktivitete të iniciuara bazuar në planin e prokurimit. Në analizimin e asaj se gjashtëdhjetë e gjashtë (67) aktivitetet të cilat janë iniciuar konformë planit të prokurimit, a

¹⁴ **Burimi:** Planet përfundimtare të prokurimit për vitin 2023.

¹⁵ **Sqarim:** Shenja (✓) nënkupton se aktiviteti i inicuar ka qenë i planifikuar, ndërsa shenja (x) nënkupton se aktiviteti i inicuar nuk ka qenë i planifikuar.

¹⁶ **Sqarim:** (N/A) nënkupton nuk aplikohet sepse asnjë nga aktivitetet e iniciuara nuk ka qenë i planifikuar.

përmbajnë detajet e njëjta si në plan ashtu edhe gjatë inicimit, të gjeturat tregojnë se vetëm një (1) prej tyre i përmbahet plotësisht planit të prokurimit, përkatësisht Komuna e Gllogocit, ndërsa tridhjetë e pesë (35) prej tyre nuk i përmbahen fare detajeve të planit të prokurimit, ndërsa tridhjetë e një (31) aktivitete detajeve të planifikuar i përmbahen në mënyrë të pjesshme.

Duke qenë se AQP udhëheqë prokurimet e përbashkëta sipas udhëzimit administrativ me qëllim të lidhjes së kontratave të centralizuara sipas produkteve të cilat parashihen në shtojcën e po këtij udhëzimi, INPO duke bashkangjitur të gjitha mostrat ka drejtuar pyetjen tek ky insitucion se: “A është njoftuar AQP sipas nenit 9 të LPP për inicimin e aktiviteteve të paplanifikuara”. Nga përgjigja e pranuar, vërejm se për nga 23 aktivitetet e inicuar të cilat nuk janë të përfshira në planin e prokurimit, 17 prej tyre janë inicuar pa njoftuar fare AQP¹⁷.

7.2. Zbatimi i planit të prokurimit tek aktivitetet për shërbime dhe për punë

Aktivitetet për shërbime dhe aktivitetet për punë bëjnë pjesë në kuadër të aktiviteteve ku Formulari B01 për planifikim të prokurimit nuk kërkon edhe shumë detaje. Rrjedhimisht, për këto aktivitete kërkohet vetëm titulli i aktivitetit, vlera e parashikuar e kontratës dhe data e planifikuar e fillimit të prokurimit.

INPO ka analizuar se pesë (5) aktivitetet e para për shërbime të iniciuara gjatë vitit 2023, fillimisht a janë të planifikuara dhe nëse janë të planifikuara a janë respektuar detajet tjera të parapara me plan të prokurimit. Në tabelën më poshtë janë paraqitur detajet lidhur me këto gjetje për secilën komunë.

Përputhja e pesë (5) aktiviteteve për shërbime me planin përfundimtar të prokurimit								
Nr.	Komuna	Planifikimi					Përputhja me detajet e paraqitura në plan të prokurimit	
		1	2	3	4	5	Po	Jo
1.	Deçan	✓	✓	✓	x	x	3	0
2.	Dragash	✓	x	x	x	✓	2	0
3.	Ferizaj	✓	x	✓	✓	✓	2	2
4.	Gllogoc	✓	✓	✓	✓	x	2	2
5.	Gjakovë	✓	✓	x	✓	✓	2	2
6.	Gjilan	✓	✓	✓	x	✓	2	2
7.	Kaçanik	x	✓	x	x	✓	2	0
8.	Kamenicë	✓	✓	✓	✓	✓	4	1
9.	Klinë	x	✓	x	x	x	0	1
10.	Pejë	✓	✓	✓	✓	✓	5	0
11.	Podujevë	✓	✓	✓	✓	x	4	0
12.	Prishtinë	x	x	x	x	x	0	0
13.	Prizren	x	✓	x	x	x	1	0
14.	Rahovec	✓	✓	✓	✓	✓	4	1
15.	Suharekë	✓	x	✓	✓	✓	4	0
16.	Shtime	✓	✓	✓	✓	✓	4	1

¹⁷ **Burimi:** Kërkesë për qasje në informacion në Agjencin Qendrore të Prokurimit

17.	Viti	✓	✓	✓	✓	✓	4	1				
18.	Vushtrri	✓	✓	✓	✓	✓	2	3				
Gjithsej		<table border="1"> <tr> <td>63</td> <td>27</td> </tr> <tr> <td>✓</td> <td>x</td> </tr> </table>					63	27	✓	x	47 nga 63	16 nga 63
63	27											
✓	x											

Tabela 3: Përputhja e pesë (5) aktiviteteve për shërbime me planin përfundimtar të prokurimit.

Të dhënat në tabelën e paraqitur dëshmojnë se nga nëntëdhjetë (90) aktivitetet e para për shërbime të iniciuara nga tetëmbëdhjetë (18) komuna, vetëm gjashtëdhjet e tri (63) prej tyre kanë qenë të planifikuara, ndërsa njëzet e shtatë (27) prej tyre fare nuk figurojnë në planin e prokurimit të vitit 2023. Gjithashtu, INPO ka identifikuar edhe aktivitetet e prokurimit të cilat kanë qenë të planifikuara dhe iniciuara në përputhje me detajet e parapara në plan të prokurimit, kështu dyzet e shtatë (47) aktivitete të prokurimit janë të iniciuara në përputhje me planin ndërsa, gjashtëmbëdhjetë (16) aktivitete janë iniciuar në kundërshtim me planin e prokurimit, plan hartues i të cilës është vet AK.

INPO gjithashtu ka analizuar edhe pesë (5) aktivitetet e para për punë të iniciuara gjatë vitit 2023, ku pjesë e analizës është ajo se a janë të planifikuara këto aktivitete me plan përfundimtar të prokurimit dhe nëse janë të planifikuara a janë respektuar detajet tjera të parapara me plan të prokurimit. Në tabelën më poshtë janë paraqitur detajet lidhur me këto gjetje për secilën komunë.

Përputhja e pesë (5) aktiviteteve për punë me planin përfundimtar të prokurimit								
Nr.	Komuna	Planifikimi					Përputhja me detajet e paraqitura në plan të prokurimit	
		1	2	3	4	5	Po	Jo
1.	Deçan	✓	✓	✓	✓	x	0	4
2.	Dragash	✓	✓	✓	✓	✓	3	2
3.	Ferizaj	✓	x	✓	✓	✓	4	0
4.	Glllogoc	✓	✓	✓	✓	✓	2	3
5.	Gjakovë	✓	✓	✓	✓	✓	4	1
6.	Gjilan	✓	✓	✓	x	x	1	2
7.	Kaçanik	✓	✓	x	✓	x	2	1
8.	Kamenicë	✓	✓	✓	✓	x	1	3
9.	Klinë	✓	x	✓	✓	✓	3	1
12.	Pejë	✓	✓	✓	✓	✓	2	3
13.	Podujevë	✓	✓	✓	x	✓	4	0
14.	Prishtinë	x	x	x	✓	✓	1	1
15.	Prizren	x	x	x	✓	✓	0	2
16.	Rahovec	✓	✓	✓	x	✓	1	3
17.	Suharekë	✓	✓	✓	✓	✓	0	5
18.	Shtime	✓	✓	✓	✓	✓	5	0
19.	Viti	x	✓	✓	✓	✓	2	2
20.	Vushtrri	✓	✓	✓	✓	✓	3	2

Gjithsej	73	17	38 nga 73	35 nga 73
	✓	x		

Tabela 4: Përputhja e pesë (5) aktiviteteve për punë me planin përfundimtar të prokurimit.

Të dhënat në tabelë tregojnë se komunat kanë iniciuar edhe aktivitete për punë të cilat fare nuk kanë qenë të planifikuara. Nga pesë (5) aktivitetet e para për punë në tetëmbëdhjetë (18) komuna, shtatëmbëdhjetë (17) aktivitete janë iniciuar pa qenë fare të planifikuara, ndërsa shtatëdhjetë tri (73) prej tyre janë iniciuar bazuar në planin e prokurimit nga AK-të.

INPO ka analizuar shtatëdhjetë e tre (73) aktivitetet e monitoruara nëse të njëjtat i përmbajnë detajet sipas planit përfundimtar të prokurimit. Kësisoj të gjeturat tregojnë se nga shtatëdhjetë e tre (73) aktivitetet e prokurimit, tridhjetë tetë (38) nga to janë të cilat i përmbajnë planet e prokurimit, ndërsa tridhjetë e pesë (35) prej tyre nuk i përmbajnë të dhënat sikur plani i prokurimit.

Në bazë të kësaj, përkundër që Formulari B01 për planifikim të prokurimit, sa u përket aktiviteteve për shërbime dhe aktiviteteve për punë, nuk kërkon shumë detaje, gjetjet dëshmojnë që as këto detaje nuk respektohen nga komunat. Në fakt përkundër që gjatë inicimit titulli i aktivitetit është i njëjtë sikur në plan, detajet tjera elementare siç janë vlera e parashikuar në shumë raste është e ndryshme dhe në kundërshtim me planin përfundimtar të prokurimit.

8. Tejkalmi i vlerës së parashikuar të planit të prokurimit dhe përqindja e buxhetit të shpenzuar

Inicimi i aktiviteteve të prokurimit në përputhje me planin e prokurimit del të jetë sfiduese për AK-të, këtë e kanë dëshmuar të gjitha raportet e INPO-s sa i përketë monitorimit të planifikimit të prokurimit ndër vite. Kjo dukuri shqetësuese ndodh në rastet kur AK nuk iniciojnë aktivitetet e prokurimit në përputhje me planin e prokurimit apo edhe kur inicimi i aktiviteteve të prokurimit bëhet pa qenë fare të planifikuara, dukuri e cila po përsëritet vazhdimisht nga ana e tyre.


Kështu, INPO ka analizuar planet e prokurimit të tetëmbëdhjetë (18) komunave duke i krahasuar vlerën e parashikuar për kategoritë e furnizimeve, shërbimeve dhe punëve të parapara në planin e prokurimit me vlerën totale të aktiviteteve të iniciuara. Të gjeturat e INPO-s, tregojnë se ka komuna të cilat kalojnë mbi 500% buxhetin e planifikuar, ndërsa disa AK të tjera nuk kanë shpenzuar as gjysmën e buxhetit. Të gjitha të gjeturat do të gjenden të listuara më poshtë dhe të analizuar individualisht për aktivitetet për furnizim, shërbim dhe punë.

8.1. Furnizimet

Kontratat për furnizim lidhen nga AK-të me një ose më shumë furnizues kryesisht për blerjen, qiradhënien, qiramarrjen ose blerje me këste. Në kuadër të furnizimit hyn produkte të prekshme/lëvizshme siç janë mallrat, artikujt, prodhimet, paisjet dhe lëndet e para¹⁸.

¹⁸ Shih, nenin 4, paragrafi 1.60 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, me plotësim ndryshim të Ligjit Nr. 05/L-068, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>

Kësisoj, INPO ka krahasuar vlerën e parashikuar në total të aktiviteteve për furnizim të tetëmbëdhjet (18) komunave në planin e prokurimit me vlerën totale të aktiviteteve të inicuar, se sa përqind e kanë tejkuluar vlerën e planifikuar për aktivitetet për furnizim dhe sa prej AK nuk e kanë tejkuluar vlerën e aktiviteteve të planifikuara në planin përfundimtar, respektivisht përqindja e buxhetit të shpenzuar për secilen komunë.



Grafika 1. Tejkalmi i vlerës së parashikuar dhe % e buxhetit të shpenzuar për aktivitetet e planifikuara tek furnizimet


Të dhënat në grafikën më lartë dëshmojnë se për nga përqindja më e lartë, komuna e cila ka tejkuluar vlerën e parashikuar sipas planit të prokurimit për aktivitetet për furnizim është Komuna e Deçanit me 81%, pasuar nga Komuna e Prishtinës dhe Ferizajt me 39% dhe Komuna e Glllogocit me 34%. Ndërsa, ka disa komuna që as gjysmën e buxhetit të planifikuar për këto aktivitetet nuk i kanë shpenzuar. Komuna me më së paku buxhet të shpenzuar për aktivitetet për furnizim shprehur në përqindje janë: Komuna e Dragashit me 28%, Komuna e Klinës me 41%, pasuar nga Komuna e Rahovecit me 56% të buxhetit të shpenzuar për aktivitetet për furnizim.

Përkritazi me të dhënat e paraqitura më lartë, paraqiten dy anët e medaljes së autoriteteve kontraktuse të cilat ndahen në dy grupe: AK që kanë tejkuluar vlerën e parashikuar sipas planit të

prokurimit për aktivitetet për furnizim dhe ato AK të cilat nuk kanë arritur ta shpenzojnë as buxhetin e planifikuar për këto aktivitete për periudhën tetë (8) mujore. Të gjitha këto qojnë në një rezultat të vetëm, i cili është keqmenaxhim i shpenzimit të paras publike dhe përgjegjësia për këtë bje mbi njësitë e kërkesës dhe zyren e prokurimit.

8.2. Shërbimet

Ndryshe nga furnizimet, kontratat për shërbim sipas LPP “është një kontratë duke përjashtuar kontratat e punës apo furnizimit me shpërblim me para, të lidhur me shkrim ndërmjet autoritetit kontraktues dhe një ose më shumë ofruesve të shërbimeve”¹⁹. Pra, kontratat të cilat nuk mund të përfshihen në kategorinë e furnizimit dhe punëve, hynjë në kategorinë e shërbimeve siç janë: shërbimet të ndryshme konsulente²⁰, shërbime të mirëmbajtjes apo të atyre të sigurisë e kështu me radhë.



¹⁹ Shih, nenin 4, paragrafi 1.57 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, me plotësim ndryshimin e Ligjit Nr. 05/L-068, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>

²⁰ **Sqarim:** Për shërbimet e veçanta të konsulences, KRPP në vitin 2020 ka lëshuar një rekomandim i cili ndalon rekrutimin e stafit përmes procedurave të prokurimit, për pozitat e rregullta sipas Ligjit për Zyrtarë Publik.

Grafika 2. Tejkalmi i vlerës së parashikuar dhe % e buxhetit të shpenzuar për aktivitetet e planifikuara tek shërbimet

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se AK të cilat e kanë tejkeluar vlerën e parashikuar për aktivitetet për shërbim janë: Komuna e Kaçanikut me 525%. Në parim, kjo shifër duket astronomike, mirëpo kjo është komuna e cila ka tejkeluar mbi gjashtë (6) fishë vlerën e parashikuar në planin e prokurimit për aktivitetet të cilat i ka inicuar, për kategorin e shërbimeve Komuna e Kaçanikut në plan të prokurimit ka paraparë vetëm 41,000.00 euro. Pasohet nga Komuna e Podujevës me 76% dhe Komuna e Kamenicës me 38%. Ndërsa, komunat të cilat kanë nuk e kanë shfrytëzuar në tërësi buxhetin për këtë kategori janë: Komuna e Ferizajt me 9%, Komuna e Deçanit me 41% dhe Komuna e Suharekës 55%. Sipas raportit gjashtëmujor financiar të buxhetit të Republikës së Kosovës shpenzimet për mallra dhe shërbime (përfshirë shpenzimet komunale) shënuan vlerën prej 157.20 milionë euro, duke shënuar një rritje prej 14.94 milionë euro, duke arritur kështu normën e ekzekutimit në 32% krahasuar me vlerën totale vjetore të buxhetuar për këtë kategori, ose rritje prej 10% krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022.²¹

Pra, komunat përveq që i iniciojnë aktivitetet e paplanifikuara në të njëjtën kohë në disa raste tejkalmi i vlerës së parashikuar e këtyre aktivitetëve del të jetë shumëfishë më e lartë. Në këtë rast komunat duhet të ndërmarrin të gjitha veprimet e nevojshme dhe konkrete për përmirsimin e shpenzimit të parasë publike dhe realizimin e buxhetit sipas aprovimit të tij në secilin kuvend komunal.


8.3 Punë

AK-të iniciojnë procedurat e prokurimit me qëllim nënshkrimit të kontratës dhe implemtimin e saj në tërësi për të gjitha kategoritë. Mirëpo, ndryshe nga furnizimet dhe shërbimet, pjesa më e madhe e buxhetit të nivelit lokal, ashtu sikurse ai qendror orientohet tek investimet kapitale, respektivisht projektet për punë. Sipas LPP *”kontrata me shpërblim në para, të lidhur ndërmjet autoritetit kontraktues dhe një ose më shumë kontraktuesve të punëve i cili ka detyrë kryesore zbatimin, projektimin dhe përmbushjen, ose realizimin, me çfarëdo mënyre, të punës ose ndërtimit ose aktivitetëve ndërtimore komunale”*.²²

Kësisoj, INPO ka monitoruar komunat të cilat kanë tejkeluar vlerën e parashikuar për aktivitetet për punë sipas planit përfundimtar të prokurimit dhe përqindja e buxhetit të shpenzuar për komunat të cilat nuk e kanë tejkeluar vlerën e parashikuar. Të gjitha të dhënat i gjeni të listuara në grafiken më poshtë.

²¹ Shih, raportin gjashtëmujor financiar të Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2023 https://mf.rks-gov.net/desk/inc/media/1675633B-7E7D-4FEA-9803-7DFDD4CE5FE0.pdf?fbclid=IwAR01a9xxxS_2yW-agYci7psAA0VilUwAPMRjf2whaeFL_uNJo_W2dIpaUYM

²² Shih, nenin 4, paragrafi 1.72 i Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, me plotësim ndryshimin e Ligjit Nr. 05/L-068, i qasshëm në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>



Grafika 3. Tejkalmi i vlerës së parashikuar dhe % e buxhetit të shpenzuar për aktivitetet e planifikuara tek punë

Të dhënat e paraqitura më lart tregojnë se katërbëdhjetë (14) nga tetëmbëdhjetë (18) komunat e monitoruara kanë tejkaluar vlerën e parashikuar në planin përfundimtar të AK-ve. Respektivisht, Komuna e Deçanit prin për sa i përket tejkalimit të vlerës me 350%, Komuna e Kamenices me 249% dhe Komuna e Prizrenit me 112%. Ndërkaq, komunat me më së paku buxhet të shpenzuar, shprehur në përqindje për investime kapitale janë: Komuna e Prishtinës me 32%, Komuna e Vitisë me 33% dhe Komuna e Kaçanikut me 72%. Të gjitha të dhënat e paraqitura tregojnë paaftësin e komunave në planifikimin e duhur të aktiviteteve të cilat inicohen përgjatë një viti fiskal.

Shpenzimi i parasë publike në investime apo projekte kapitale patjetër që është proces i rëndësishëm, mirëpo një shpenzim i tillë duhet të jetë paraprakisht i hartuar konform kërkesave ligjore. Bazuar në raportin gjashtëmujor financiar të buxhetit të Republikës së Kosovës shpenzimet për investime kapitale për periudhën gjashtë (6) mujore kanë shënuar rritje, saktësisht

90% më shumë krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2022²³. Ndërkaq, raporti i fundit i Eorl Bank për Kosovën thekson nevojën e përmisimit të gjendjes të menaxhimit të investimeve kapitale, kjo sepse i njëjti raport në mesin e dobësive ka listuar edhe dobësitë në menaxhimin e investimeve publike apo më saktësisht planifikimin e dobët të investimeve kapitale²⁴.

Duke marrë parasysh këto dobësi, INPO vlerëson se AK duhet të ndërmarrin hapa konkret për respektimin e planit të prokurimit dhe hartimin dhe zbatimin e tij karshi legjislacionit primar dhe sekondar. Në të kundërtën nëse një plan i tillë nuk respektohet dhe konsiderohet vetëm formalitet, atëherë mund të paraqet problem në implementimin e tij, i cili rrezikon edhe performancën komunale.

9. Institucionet përgjegjëse për zbatimin e planifikimin e prokurimit

Plani i prokurimit pasqyron rezultatet e investimeve të cilat parashihen të realizohen brenda periudhës një vjeçare për një AK. Kështu, i njëjti duhet hartuar nga zyra e prokurimit në bashkëpunim me njësinë e kërkesës sipas Formularit B01 të hartuar nga KRPP dhe po i njëjti përcjellat tek AQP për identifikimin e prokurimeve të përbashkëta. Ndërsa, IKAP është përgjegjës për koordinimin e trajnimeve të zyrtarëve publik (në nivel qendror dhe lokal) për avancimin dhe profesionalizimin e tyre në mënyrë që zyrtarët e prokurimit të paisjen me njohuri dhe aftësi të kualifikuara në fushën e prokurimit.

Këto institucionet kyçe të lartpërmendura luajnë rol thelbësor në jetësimin e planit të prokurimit në tërësi, andaj me qëllim të transparencës INPO ka analizuar rolin dhe impaktin e këtyre institucioneve publike në raport me planin e prokurimit.

9.1 Autoriteti Kontraktues

Autoriteti Kontraktues është institucioni i parë dhe përgjegjësi kryesor për hartimin e planit të prokurimit. Respektivisht, hartimi i planit të prokurimit është përgjegjësi e zyrtarit përgjegjës të prokurimit, i njëjti për të pasur një plan të suksesshëm të prokurimit dhe të zbatueshëm në tërësi duhet bashkëpunuar ngusht me njësitë e kërkesës brenda AK të cilët paraqesin projektet/kërkesat e tyre të cilat priten të realizohen në atë vit fiskal²⁵.

Përveq legjislacionit primar dhe sekondar të Republikës së Kosovës të cilat koordinojn bashkëpunimin në mes të zyrës së prokurimit dhe njërive të kërkesës, rekomandime për një bashkëpunim të tillë kanë pasqyruar edhe raportet e OECD/SIGMA-s, në të cilat thuhet se përparësi e procesit të planifikimit të prokurimit është “Krijimi i lidhjeve ndërmjet palëve të interesit,

²³ Shih raportin gjashtëmujor financiar të Republikës së Kosovës për vitin 2023 https://mf.rks.gov.net/desk/inc/media/1675633B-7E7D-4FEA-9803-7DFDD4CE5FE0.pdf?fbclid=IwAR01a9xxxS_2yVW-agYci7psAA0VilUwAPMRjf2whaeFL_uNJo_W2d1pauYM

²⁴ Për më shumë shih raportin e WorldBank për Kosovën i vitit 2023 https://documents1.worldbank.org/curated/en/099041723104545397/pdf/BOSIB0a3dc36ae0c40be3c058429f10a40d.pdf?fbclid=IwAR3ta0K-1Y0o9DA02px3VhMsyIRqi_oBfz924tE6mBAaB3zEfKu7p6wdcgM

²⁵ Për më shumë shih raportin e INPO-s, <http://inpo-ks.org/wp-content/uploads/2021/12/Planifikimi-i-prokurimit-n%C3%AB-mes-t%C3%AB-formalitetit-dhe-profesionalizmit.pdf>, i vitit 2021

departamentit të financave dhe stafit të prokurimit”.²⁶ Kësisoj, një planifikim i përbashkët konsolidon një planifikim të prokurimit të zbatueshëm në praktik.

Mirëpo, sipas të gjeturave jo gjithmonë rezulton që në mes zyres së prokurimit dhe njërive të kërkesës ekziston një bashkëpunim i mirëfillt, bashkëpunim i cili do të mund të bënte planin e prokurimit të zbatueshëm në praktikë dhe i njëjti të përmbushë nevojat e AK-së. INPO gjatë vitit 2022 ka realizuar një (1) anketë me nga një njësi të kërkesës për komunitetet e monitoruara të cilat kanë inicuar aktivitetet të paplanifikuara. Sipas përgjigjeve të anketueseve përgjegjësia për planifikimin e prokurimit ndahet në pjesë të barabarta, pra 43.8% e tyre mendojnë se është përgjegjësi e njësisë së kërkesës dhe 43.8% mendojnë se është përgjegjësi e njësisë së kërkesës dhe zyres së prokurimit. Ndërsa, 6.3% mendojnë se është përgjegjësi e njërive të kërkesës dhe 6.3% të tjerë mendojnë se përgjigjësia bie mbi zyren e prokurimit.²⁷

Thënë më lartë, zyra e prokurimit dhe njëria e kërkesës duhet të sigurohen që të hartojnë bashkarisht planin e prokurimit bazuar në nevojat e qytetarëve duke respektuar njëkohësisht edhe obligimet ligjore dhe procedurale që ndërliken me të.²⁸ Në të kundërtën një plan i prokurimit i dobët dhe jo i zbatueshëm mund të sjellë pasoja të paparashikueshme për AK-të. Pasoja të paparashikueshme sepse AK-të mund të përballen situata të vështira gjatë udhëheqjes së procedurave të prokurimit e që mund të shpien edhe deri në anulimin e një aktiviteti të prokurimit në tërësi. Anulimin e aktiviteteve të prokurimit për shkak të mungesës së duhur të planifikimit e dëshmon edhe raporti vjetor i punës së KRPP, në të cilin raport janë listuar dobësit e evidentuara për vitin 2022 në prokurimin publik.²⁹

9.2. Agjencia Qendrore e Prokurimit

Plani i prokurimit është plan i cili përgaditet nga AK-të për periudhën dymbëdhjetë (12) mujore, mbi bazën e të cilit listohen të gjitha furnizimet, shërbimet apo punët të cilat AK-të planifikojnë ti realizojnë për atë vit. I njëjti, pra plani i prokurimit pas hartimit sipas obligimeve ligjore dhe procedurale duhet të dërgohet në AQP. LPP parashihet se: *“Brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve pas shpalljes së legjislacionit mbi përvetësimet për një vit fiskal, çdo autoritet kontraktues do të përgatisë, në rast të një autoriteti publik apo një ndërmarrje publike duhet t’i dorëzojë AQP-së, një planifikim përfundimtar me shkrim që i identifikon me detale të arsyeshme të gjitha furnizimet, shërbimet dhe punët që autoriteti kontraktues synon ti prokurorë gjatë vitit të tillë fiskal.”*³⁰

²⁶ Për më shumë shih raportin e SIGMA-s për prokurimin publik të vitit 2015, <https://www.sigmaweb.org/publications/Module-C-%202015-clean.pdf>, faqe 5.

²⁷ Për më shumë shih raportin e INPO-s, <http://inpo-ks.org/wp-content/uploads/2022/12/Raport-Planifikimi-i-Prokurimit-2022.pdf> i vitit 2022

²⁸ Për më shumë shih nenin 10 të RrP: https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/Rregullore%20Nr.001_2022%20p%C3%ABr%20prokurimin%20publik.pdf

²⁹ Për më shumë shih Raportin Vjetor të KRPP-së për vitin 2022, <https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Raportet%20Vjetore/shq/Raporti%20vjetor%202022.pdf>

³⁰ Për më shumë shih nenin 8, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik, me plotësim ndryshim të Ligjit Nr. 05/L-068, i qasur në: <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2772>

Pra, roli dhe përgjegjësia e AQP-s në këtë rast është mbledhja e prokurimeve të përbashkëta bazuar në planin përfundimtar të secilit AK të Republikës së Kosovës, kjo sepse është kompetencë e AQP-s sipas Udhëzimit Administrativ për zbatimin e procedurave qendrore³¹, për udhëheqjen e prokurimeve të përbashkëta sipas nevojave të AK-së me qëllim të rritjes së efikasitetit dhe transparencës përmes aplikimit të procedurës së përbashkët apo të konsoliduar të prokurimit ose përmes përdorimit të kontratave qendrore kornizë³².

Mirëpo, përkundër afatit të paraparë sipas legjislacionit primar dhe sekondar për dërgimin e planit të prokurimit në AQP, INPO ka identifikuar disa raste kur AK-të kanë dërguar planin e prokurimit, pas afatit të paraparë ligjor, respektivisht Komuna e Dragashit, Kaçanikut dhe Gjilanit. Si rrjedhojë, kemi drejtuar pyetje pranë AQP se cilat kanë qenë veprimet e tyre konform këtyre AK-ve, por e njëjta ka refuzuar të përgjigjet. Kjo lë të nënkuptohet se AQP nuk ka ndërmarr ndonjë veprim konkret ndaj këtyre AK-ve përkundër që po të njëjtit në pyetjet e parashtruara rreth respektimit të procedurave për planifikim të njëjtit janë përgjigjur se kanë hasur vështirësi në prokurimin e procedurave të përbashkëta³³.

Kësisoj, AQP si institucion përgjegjës për udhëheqjen e prokurimeve të përbashkëta, duhet të krijoj mekanizem detyrues për AK, i cili i obligon ndër të tjerash që planet e prokurimit i pranon brenda afatit të paraparë ligjor e që rrjedhimisht do të bënte institucionet më përgjegjëse nga njëra anë dhe anën tjetër për AQP do të lehtësohej procesi i identifikimit të prokurimeve të përbashkëta dhe njëkohësisht implementimi i kontratave të nënshkuara.

9.3. Komisioni Rregullativ për Prokurim Publik

KRPP, bazuar në legjislacionin primar dhe sekondar përveq monitorimit të aktiviteteve të prokurimit prej inicimit deri te nënshkrimi i kontratës dhe prej nënshkrimit të kontratës deri në përfundimin e saj është përgjegjës edhe për mbikqyrjen e zbatimit të rregullave të prokurimit në përgjithësi dhe rrjedhimisht edhe planifikim të prokurimit në mënyrë që gjetjet e tyre të adresohen në rrugë institucionale.

INPO në vitin 2021³⁴ duke parë KRPP-në si të pa involvuar në mbikqyrjen e planifikimit të prokurimit, ka rekomanduar që KRPP përmes mekanizmave të saj të monitoroj këtë proces. Sipas komunikimeve zyrtarë me KRPP INPO është njoftuar se *”nga gjysma e këtij viti (lexo 2023) KRPP ka filluar përdorimin e metodologjisë së re të monitorimit ku njëra nga pikat në metodologjinë e monitorimit është edhe planifikimi i prokurimit”*. Orientimisht, gjetjet e monitorimit të planifikimit të prokurimit nga KRPP do të përfshihen në raportin vjetor të punës së KRPP-së, i cili zakonisht publikohet në verën e vitit pasues.

³¹ Për më shumë shih, Udhëzimin për Zbatimin e Procedurave Qendrore të Prokurimit Publik, i qasshëm në <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=18812>

³² Për më shumë shih nenin 5.5 të RrP, i qasshëm në: https://e-prokurimi.rks-gov.net/HOME/Documents/Legislation/Rregulloret/shq/Rregullore%20Nr.001_2022%20p%C3%ABr%20prokurimin%20publik.pdf

³³ **Burimi:** Intervistë me Agjencin Qendrore të Prokurimit

³⁴ Për më shumë, shih raportin e INPO-s, <http://inpo-ks.org/wp-content/uploads/2021/12/Planifikimi-i-prokurimit-n%C3%AB-mes-t%C3%AB-formalitetit-dhe-profesionalizmit.pdf?fbclid=IwAR0D2toIVe4w4YSBpZ4DqoabNI1K4Z1i3GzESsvNu3ejSoHliokYAfrGE>

INPO gjatë hulumtimit ka hasur në gjetje të ndryshme sa i përket zbatimit të planit të prokurimit, përfshirë këtu mosrespektimin e kërkesave formale të Formularit B01. Kësisoj, INPO me datë 22.09.2023 pranë KRPP ka parashtuar kërkesë për qasje në informacion dhe dokumente publike nëpërmjet të cilës kemi pytur se: “A mendoni se kërkesat e Formularit B01 duhet të ndryshohen?”. Përgjigja e KRPP lidhur me këtë pyetje ka qenë: “Aktualisht KRPP nuk ka ndonjë plan apo veprim të bëhet asnjë lloj ndryshimi apo amandemantimi të këtij formulari pasi që jemi në fazën e ndryshimit të Ligjit, andaj konform këtyre ndryshimeve do të behët vlerësimi i nevojave për përshtatje të kërkesave rreth këtij formulari dhe jo vetëm³⁵”. Ju rikujtojm, se Formulari B01 hyn në kuadër të legjislacionit sekondar dhe rrjedhimisht nuk varet nga plotësim-ndryshimi i legjislacionit primar, përkundër faktit se të njejtat duhet të jenë në harmoni me njëri-tjetrin. Gjetjet e vazhdueshme tregojnë se AK-të nuk i përfillin këto rregulla dhe se nevoja për ridizajnim të një formulari të tillë është kruciale.

Kështuqë, INPO vlerëson se nevojitet një bashkëpunim i mirëfillt në mes të KRPP-së dhe IKAP së bashku me institucionet të tjera relevante, në mënyrë që të organizohen trajnime si mekanizëm kyç për ngritjen e kapaciteteve në mënyrë që ky plan të hartohet ashtu siç kërkon KRPP dhe i njejtat të jetë edhe i zbatueshëm në praktikë.

10. Të gjeturat dhe ndikimi i INPO-s rreth planifikimit të prokurimit (2020-2022)

INPO me qëllim të pasqyrimin të saktë të respektimit dhe zbatimit të planeve të prokurimit, vazhdimisht ka monitoruar dhe analizuar planet e prokurimit të AK-ve, gjetjet e të cilave i ka paraqitur në raportet e saj periodike.

Korniza ligjore për prokurim publik në Kosovë rregullon në mënyrë të qartë hartimin, zbatimin dhe respektimin e planit të prokurimit. Gjetjet sipas monitorimit të vazhdueshëm të INPO-s janë: (i) Mosrespektimi i Formularit B01, (ii) Mospërputhje në mes të planifikimit dhe inicimit (iii) Inicimi i aktiviteteve të paplanifikuara, të njejtat rezultojnë të jenë probleme endemike, rrjedhimisht dukuri të papërmisueshme ndikojnë në planifikimin e dobët, madje edhe në prioritizimin e mangët karshi nevojave reale të qytetareve dhe palëve të interesit. Kësisoj, komunat duhet të krijojnë mekanizma efektive për përmisimin e planifikimit, fillimisht gjatë fazës së hartimit të tij, sepse në disa raste ky plan hartohet në momente të fundit e që si pasojë e moskoordinimit rezulton në devijime buxhetore dhe dështimin në implementimin e tij në praktikë.

Tutje, si rezultat i monitorimit dhe rekomandimeve të INPO-s, komunat gjatë vitit 2022 kanë shënuar një përmirësim të dukshëm sa i përket inicimit të aktiviteteve të paplanifikuara, respektivisht reth 75% e komunave kanë përmisuar planifikimin e prokurimit. Në vitin 2021, katërbëdhjetë (14) nga njëzet (20) komunat e monitoruara kanë inicuar tender të paplanifikuar,

³⁵ **Burimi:** Intervistë me Komisionin Rregullativ për Prokurim Publik

ndërkaq në vitin 2022 vetëm pesë (5) nga njëzet (20) komunat e monitoruara kanë inicuar tender të paplanifikuar³⁶.

Ndërsa, INPO ka krahasuar numrin e aktiviteteve të inicuar pa planifikim për vitin 2022 dhe 2023. Të dhënat e paraqitura në tabelën më poshtë tregojnë se numri i aktiviteteve të cilat janë inicuar pa planifikim në vitin 2022 dhe 2023 është pothuajse i njëjtë, me një diferencë shumë të ngushtë mesvete.

Viti	Krahasimi i aktiviteteve të inicuar pa planifikim		
	Furnizim	Shërbim	Punë
2022 ³⁷	30	22	17
2023	23	27	17
Gjithsej	-7	+5	0

Krahasuar me vitin paraprak, INPO vëren se në vitin 2023 tek kategoria e furnizimeve numri i aktiviteteve të inicuar paplanifikim është ulur në -7 nga tridhjetë (30) sa ka qenë vitin e kaluar. Ndryshe nga furnizimet, numri i aktiviteteve të inicuar pa qenë fare në plan të prokurimit për vitin 2023 tek kategoria e shërbimeve është rritur në +5 nga njëzet e dy (22) sa ka qenë në vitin 2022. Ndërsa, sa i përket kategorisë së punëve, pasqyrohet po i njëjti rezultat, sikurse në vitin 2022 ashtu edhe në atë 2023 me shtatëmbëdhjetë (17) aktiviteteve të inicuar pa qenë fare në plan të prokurimit.

Përveq krahasimit në mes të vitit 2022 dhe 2023, në bazë të numrit të aktiviteteve të cilat janë inicuar pa planifikim, INPO në vazhdim do të paraqes një rezymë të përgjithshme për vlerën e aktiviteteve të paplanifikuara përgjatë tre (3) vitave për njëzet (20) komunat të nxjerrur sipas mostrave të INPO-s dhe të gjitha të dhënat i gjeni në grafikën 4.

Të gjeturat tregojnë se AK - të vazhdimisht kanë inicuar aktivitete të paplanifikuara, rrjedhimisht vlera e aktiviteteve të paplanifikuara rezulton të jetë shumë e lartë. INPO në raportin e vitit 2020 ka analizuar aktivitetet të cilat nuk kanë qenë të planifikuara dhe kështu duke krahasuar **diferencën** në mes të vlerës në plan të prokurimit dhe njoftim për kontratë për pesë (5) kontrata për secilën komunë. Ndërsa, në vitin 2021 dhe 2022, INPO ka llogaritur vlerën totale për aktivitetet të cilat nuk kanë qenë të përfshira në planin e prokurimit.

Në vitin 2020, komuna e cila rezulton me më së shumti diferencë të shprehur në euro është ajo e Prizrenit me 4,329,500.00 euro, pasur nga ajo e Ferizajt me 808.500,00 dhe Komuna e Vitisë me 724,636.00 euro. Ndërsa, komunat të cilat nuk kanë pasur fare diferencë në mes të planifikimit

³⁶ Për më shumë shih infografiken e INPO-s rreth ndikimit në planifikimin e prokurimit <https://www.facebook.com/photo.php?fbid=674721714697172&set=pb.100064780480340.-2207520000&type=3>

³⁷ Për më shumë shih raportin e INPO-s, Planifikimi i prokurimit për vitin 2022, <https://inpo-ks.org/wp-content/uploads/2022/12/Raport-Planifikimi-i-Prokurimit-2022.pdf>

dhe inicimit të aktiviteteve të monitoruara janë ajo e Deçanit, Kamenicës, Leposaviqit. Në total diferenca e planifikimi dhe inicimit për vitin 2020 është **7,614,343.26 euro**³⁸.

Në vitin 2021, komuna lidere për inicimin e aktiviteteve të paplanifikuara të shprehur në vlerë është Komuna e Gjilanit me 4,804,179.11 euro, pasur nga Komuna e Prishtinës me 1,857,771.00 euro dhe Komuna e Prizrenit me 1,291,825.05 euro. Në total vlera e përgjithshme e aktiviteteve të inicuar pa përfshirje në plan të prokurimit të komunave të monitoruara është **14,388,801.13 euro**³⁹.

Në vitin 2022, komuna me vlerën më të lartë të aktiviteteve të paplanifikuara është Komuna e Vitisë me 3,538,156.00, pasur tutje nga Komuna e Deçanit me 3,158,817.00 euro dhe Komuna e Vushtrrisë 1,220,385.67 euro. Vlera e përgjithshme për vitin 2022 për të gjitha komunat e monitoruara është **13,563,120.98 euro**⁴⁰.

Krahasimi i vlerave të aktiviteteve të paplanifikuara në tre (3) vite			
Komuna	2020	2021	2022
Deçan	N/A	427,277.00	315,817.00
Dragash	488,050.00	167,150.00	24,500.00
Ferizaj	808,500.00	434,666.00	744,096.00
Glllogoc	69,500.00	678,811.50	456,781.31
Gjakovë	N/A	58,773.60	14,084.00
Gjilan	N/A	4,804,179.11	165,889.90
Kaçanik	55,000.00	229,070.00	280,043.35
Kamenicë	N/A	128,104.29	35,040.00
Klinë	154,700.00	254,190.00	301,300.00
Leposaviq	N/A	164,197.00	79,776.00
Mitrovicë e Veriut	20,000.00	724,224.17	167,998.00
Pejë	39,356.36	656,648.00	326,299.30
Podujevë	397,276.40	137,640.91	115,150.81
Prishtinë	135,000.00	1,857,771.00	752,700.00
Prizren	4,329,500.00	1,291,825.50	859,410.00
Rahovec	N/A	907,822.64	866,822.64
Suharekë	237,826.00	229,682.00	146,480.00
Shtime	117,000.00	80,457.72	279,391.00
Viti	724,636.00	996,326.35	3,538,156.00
Vushtrri	37,998.50	200,914.17	1,220,385.67
Gjithsej	7,614,343.26	14,388,801.13	13,563,120.98

Tabela 4. Vlera e kontratatave të paplanifikuara në tre (3) vite.

³⁸ Për më shumë shih raportin e INPO-s për vitin 2020, <https://inpo-ks.org/wp-content/uploads/2021/03/Planifikimi-i-Prokurimit-n%C3%AB-komuna.pdf?fbclid=IwAR2-Gq-Hn5jiPao0KM0Q5twwmuFhuJAA6yyldeybFDjOg7F4CvTdTVAAesY>

³⁹ Për më shumë shih ankesin në raportin e INPO-s, për vitin 2021 https://inpo-ks.org/wp-content/uploads/2021/12/Planifikimi-i-prokurimit-n%C3%AB-mes-t%C3%AB-formalitetit-dhe-profesionalizmit.pdf?fbclid=IwAR0TejB-vyzuScEYxiUjjiYDfuh5_x885TdrVqNqyjMvT6W3xAnz4bQvW4

⁴⁰ Për më shumë shih aneksin në raportin e INPO-s, për vitin 2022 https://inpo-ks.org/wp-content/uploads/2022/12/Raport-Planifikimi-i-Prokurimit-2022.pdf?fbclid=IwAR1tVkr7x6NdXh6UDtul98s98lQh1yyjXCmswsUng_D3WsRHUMQzDHypQol

I I. Gjetjet kryesore

- Përjashtuar Komunën e Klinës, komunat tjera nuk i paraqesin të gjitha detajet formale të kërkuara në planin përfundimtar të prokurimit sipas Formularit B01.
- AK nuk paraqesin detajet formale në planin përfundimtar të prokurimit siç janë: sasitë, njësit dhe artikujt.
- Në tetëmbëdhjetë (18) komunat e monitoruara, nga nëntëdhjetë (90) aktivitetet e monitoruara për furnizim vetëm gjashtëdhjetë e shtatë (67) prej tyre janë të parapara në planin e prokurimit, gjersa vetëm një (1) aktivitet për furnizim i ka detajet e njëjta si në plan të prokurimit, ashtu edhe gjatë inicimit e që është në Komunen e Glllogocit.
- Nga njëzet e tre (23) aktivitetet për furnizim të inicuar pa planifikim, shtatëmbëdhjetë (17) prej tyre janë inicuar pa informuar AQP-në sipas nenit 9 të Ligjit për Prokurim Publik.
- Nga nëntëdhjetë (90) aktivitetet e monitoruara për shërbime, vetëm gjashtëdhjetë e tre (63) prej tyre figurojnë në planin përfundimtar të prokurimit, pjesa tjetër janë inicuar pa planifikim.
- Nga nëntëdhjetë (90) aktivitetet për punë, vetëm shtatëdhjetë e tre (73) aktivitete janë inicuar sipas planit të prokurimit, pjesa tjetër nuk figurojnë planin e hartuar nga AK-të.
- Komuna e Deçanit, Ferizajt, Glllogocit, Kaçanikut, Prishtinës, Prizrenit, Suharekës dhe Vitisë kanë tejkualuar vlerën e parashikuar për aktivitetet për furnizim sipas planit të prokurimit, ndërsa Komuna e Dragashit, Gjakovës, Gjilanit, Klinës, Kamenicës, Pejës, Prishtinës, Podujevës, Rahovecit, Shtimes, Vushtrrisë nuk e kanë tejkualuar vlerën e planifikuar për këtë kategori.
- Komuna e Deçanit, Glllogocit, Ferizajt, Kaçanikut, Prishtinës, Prizrenit, Suharekës dhe Vitisë kanë tejkualuar vlerën e parashikuar për shërbim, ndërsa komunat me më së paku buxhet të shpenzuar për këtë kategori janë Komuna e Dragashit, Klinës dhe Podujevës.
- Nga tetëmbëdhjetë (18) komunat e monitoruara, 78% e tyre kanë tejkualuar vlerën e planifikuar për punë. Komuna e Deçanit, Dragashit, Ferizajt, Glllogocit, Gjakovës, Gjilanit, Kamenicës, Klinës, Pejës, Prizrenit, Rahovecit, Suharekës, Shtime dhe Vushtrri janë komuna të cilat kanë tejkualuar vlerën e planifikuar, ndërsa Komuna e Kaçanikut, Podujevës, Prishtinës dhe Vitisë nuk kanë arritur ta shpenzojnë në tërësi buxhetin e planifikuar për këtë kategori.

- Sipas matjeve të INPO-s, rezulton mungesë e koordinimit në mes të zyrës së prokurimit dhe njësive të kërkesës duke mos e pasur të qartë rolin dhe përgjegjësinë e departamenteve.
- Komunat nuk bëjnë analizë të tregut sidomos për kontratat komplekse apo ato me vlerë të madhe.
- Komuna e Dragashit, Gjilanit dhe Kaçanikut janë komuna të cilat kanë dërguar jashtë afatit planin e prokurimit në Agjencin Qendrore të Prokurimit.
- KRPP nuk monitoron planin e prokurimit të AK-vë, ndërsa një analizë për monitorimin e këtyre planeve pritët të bëhet tek në vitin 2024, meqë ky institucion në gjysmën e dytë të vitit 2023 ka filluar me metodologjin e re të monitorimit.
- Prej kur INPO në mënyrë sistematike monitoron planifikimin e prokurimit në komuna rreth 75% e komunave kanë përmisuar planifikimin e prokurimit, duke adresuar rekomandimin për mos iniciimin e aktiviteteve të paplanifikuara me plan përfundimtarë të prokurimit.
- Përgjatë tre (3) viteve monitorim, AK kanë inicuar aktivitete të paplanifikuara në vlerë prej **35,566,265.37 euro**.

I 2. Rekomandimet

- Komunat të kujdesen që plani përfundimtar prokurimit të jetë në përputhje me kërkesat ligjore dhe Formularin B01, respektivisht t'i përmbaj të gjitha të dhënat e nevojshme lidhur me aktivitetet për furnizim, shërbime dhe punë.
- Komuna e Deçanit, Dragashit, Glllogocit, Kaçanikut, Kamenicës, Klinës, Suharekës të sigurohen se nuk iniciojnë aktivitete për furnizim të cilat fare nuk janë të planifikuara.
- Përjashtuar Komunën e Kamenicës, Pejës, Rahovecit, Shtimes Vitis dhe Vushtrrisë, komunat tjera të sigurohen se nuk iniciojnë aktivitete për Shërbime të cilat fare nuk janë të planifikuara.
- Komuna e Deçanit, Ferizajt, Gjilanit, Kaçanikut, Kamenicës, Klinës, Podujevës, Prishtinës, Prizrenit, Rahovecit dhe Vitisë të kujdesen që nuk iniciojnë aktivitete për punë të cilat nuk janë të planifikuara.
- Komuna e Dragashit, Gjilanit, Kaçanikut të sigurohen se e dërgojnë planin e prokurimit brenda afeteve ligjore të parapara në Agjencin Qendore të Prokurimit, respektivisht pesëmbëdhjetë (15) ditë pas miratimit të buxhetit.
- Komunat të kujdesen se planifikojnë mirë aktivitetet për furnizim, shërbime dhe punë në mënyrë që detajet e paraqitura në plan të prokurimit të jenë të njëjta edhe gjatë inicimit të aktivitetit. Komunat vazhdimisht inicojnë aktivitete të cilat tejkalojnë buxhetin e planifikuar.
- Komunat duhet bëjnë analizën e tregut dhe të sigurojnë efikasitetin dhe efektivitetin e prokurimit për kontratat e vlerës së madhe dhe me natyrë komplekse.
- Njësitë kërkuese dhe ZPP-të planifikimin e prokurimit duhet të sigurohen që e hartojnë në bashkëpunim me njëri - tjetërin, ashtu siç e parasheh legjislacioni primar dhe sekondar.
- Autoritetet kontraktuese të sigurohen se planin e prokurimit ta kenë në përputhje me nevojat dhe kapacitetet buxhetore të tyre, nëse kjo nuk merret parasysh atëherë plani është vështirë i zbatueshëm.
- Insitucionet përgjegjëse për prokurim publik, të sigurohen në implementimin dhe zbatimin e planit të prokurimit publik sipas obligimeve ligjore.
- KRPP dhe IKAP duhet të bashkëpunojnë ngushtë për të dizajnuar tranime të veçanta për planifikimin e prokurimit.

13. Aneks I: Pesë (5) aktivitetet e para për furnizime, shërbime dhe punë në tetëmbëdhjetë (18) komuna

KOMUNA E DEÇANIT							
Pesë (5) aktivitetet e para të iniciuara për furnizim gjatë vitit 2023							
Nr.	Titulli i aktivitetit	Planifikimi			Inicimi		
		Sasia	Njësia	Vlera €	Sasia	Njësia	Vlera €
1.	Furnizim me materiale zyrtare (të ndryshme) për institucionet publike të Komunës së Deçanit. <i>Numri i prokurimit: 631-23-1574-1-1-1</i>	I	Komplet	300.000,00	18 165 2 9 2 1	Bllok Cope Komp M2 Pako Risa	300.000,00
2.	Furnizim me pajisje speciale mjekësore për QKMF "Adem Ukëhaxhaj" Deçan <i>Numri i prokurimit: 631-23-2743-1-2-1</i>	N/A	N/A	N/A ⁴¹	9	Copë	39,466.00
3.	Furnizim me pajisje për kërkim shpëtim <i>Numri i prokurimit: 631-23-2764-1-2-1</i>	N/A	N/A	N/A	389	Komplet	58,931.00
4.	Furnizim me krora dhe lule për manifestime të ndryshme <i>Numri i prokurimit: 631-23-2941-1-3-6</i>	I	Copë	6,000.00	960	Copë	6,900.00
5.	Blerja e motorrave Atv 6x6 dhe pjesëve shtesë (rrotëve zingjirë) <i>Numri i prokurimit: 631-23-2901-1-2-1</i>	N/A	N/A	N/A	2	Copë	62,000.00
Pesë (5) aktivitetet e para të iniciuara për shërbime gjatë vitit 2023							
Nr.	Titulli i aktivitetit	Planifikim/Vlera €			Inicim/Vlera €		
1.	Zerimi për manifestime të ndryshme në Deçan <i>Numri i prokurimit: 631-23-1703-2-3-6</i>	9,900.00			9,900.00		
2.	Shërbim me tenda dhe karrika për manifestime <i>Numri i prokurimit: 631-23-2325-2-3-6</i>	9,900.00			9,900.00		
3.	Mirmbajtja e kamerave të qytetit dhe institucioneve tjera <i>Numri i prokurimit: 631-23-4120-2-2-1</i>	120,000.00			120,000.00		
4.	Shërbime rreth informimit për përcjelljen e aktiviteteve të asamblesë komunale <i>Numri i prokurimit: 631-23-4676-2-3-6</i>	N/A			9,900.00		
5.	Transporti dhe qëndrimi në Durrës për stafin e Shtëpisë së komunitetit <i>Numri i prokurimit: 631-23-6992-2-3-6</i>	N/A			3,000.00		
Pesë (5) aktivitetet e para për punë të iniciuara gjatë vitit 2023							
Nr.	Titulli i aktivitetit	Planifikim/Vlera €			Inicim/Vlera €		
1.	Ndërtimi i rrethojave dhe rregullimi i hapësirave brenda në oborret e Qendrës Rinore, Higjienës dhe Kolonisë së Artistëve <i>Numri i prokurimit: 631-23-1386-5-2-1</i>	100.000,00			381,219.00		
2.	Asfaltimi i rrugëve dhe rrugicave në fshatrat e komunës së Deçanit-Lloti III <i>Numri i prokurimit: 631-23-1479-5-1-1</i>	200.000.00			3,555,295.00		
3.	Ndërtimi i kanaleve të ujitjes në Deçan, Carrabreg, Beleg, Kodrali, Irzniq <i>Numri i prokurimit: 631-23-1850-5-1-1</i>	180.000,00			1,799,036.00		
4.	Renovimi i objektit të Zjarrëfiksëve <i>Numri i prokurimit: 631-23-2627-5-2-1</i>	50.000,00			198,020.00		
5.	Ndërtimi i rrethojës në SHMU "Ardhmëria" Beleg <i>Numri i prokurimit: 631-23-2861-5-2-1</i>	N/A			79,618.00		
KOMUNA E DRAGASHIT							
Pesë (5) aktivitetet e para të iniciuara për furnizim gjatë vitit 2023							
Nr.	Titulli i aktivitetit	Planifikimi			Inicimi		
		Sasia	Njësia	Vlera €	Sasia	Njësia	Vlera €

⁴¹ **Sqarim:** (N/A) në të gjitha rastet në Aneks I nënkupton se aktiviteti nuk figuron fare në planin përfundimtar të prokurimit.

1.	Furnizimi me material hixhienik per nevojat e Komunes së Dragashit dhë njësjve Operative të saja <i>Numri i prokurimit: 621-23-715-1-3-6</i>	N/A	N/A	N/A	7343 85 95 1560 150	Cope Paketim Pale Kmplet Thas	9,900.00
2.	Furnizimi me material te IT per Drejtorin e Administrates - Dragash <i>Numri i prokurimit: 621-23-2343-1-3-6</i>	NA	NA	NA	7	Copë	2,700.00
3.	Furnizimi me dosje te fajllit (rexhistratora) për K.K. Dragash <i>Numri i prokurimit: 621-23-4230-1-3-6</i>	N/A	N/A	N/A	2000	Copë	4,000.00
4.	Furnizim me pelet per AMF-te ne Restelic, Brod, Rapçë dhe shkollen filllore " Fetah Sylejmani" ne Dragash <i>Numri i prokurimit: 621-23-5701-1-2-1</i>	NA	NA	NA	36	Tone	13,680.00
5.	052-Furnizim me lende djegese (dru ahu ose bungu) per nevojat e K.K.Dragashit <i>Numri i prokurimit: 621-23-5682-1-1-1</i>	/ ⁴²	/	118,571.00	/	Meter hapsinor	155,700.00
Pesë (5) aktivitetet e para të iniciuara për shërbime gjatë vitit 2023							
Nr.	Titulli i aktivitetit	Planifikim/Vlera €			Inicim/Vlera €		
1.	Hartimi i projekteve për nevojat e Kumunës së Dragashit(12 muaj) <i>Numri i prokurimit: 621-23-601-2-2-1</i>	40,000.00			40,000.00		
2.	Vizitë studimore e delegatëve të Kuvendit të Komunës dhe stafit mbështetës ne Bashkinë e Shkodrës-Shqipëri <i>Numri i prokurimit: 621-23-2729-2-3-6</i>	N/A			2,200.00		
3.	Heqja e pengesave nga metali ne trotoare dhe vendosja e vazove levisese nga betoni ne rrethojen e komunes dhe trotoare ne Dragash <i>Numri i prokurimit: 621-23-3208-2-2-1</i>	N/A			12,000.00		
4.	Vizitë studimore ne Republikën e Turqisë për delegatët e Kuvendit Dragash <i>Numri i prokurimit: 621-23-4568-2-2-1</i>	N/A			17,000.00		
5.	Mirembajtja ish objektit te shkolles se mjekesise ne fshatin Bresane - K.K. Dragash <i>Numri i prokurimit: 621-23-6544-2-3-6</i>	6,470.00			7,000.00		
Pesë (5) aktivitetet e para për punë të iniciuara gjatë vitit 2023							
Nr.	Titulli i aktivitetit	Planifikim/Vlera €			Inicim/Vlera €		
1.	Ndërtimi i ujësjellësit Kryesor në Dragash, Xerxë, Rrencë, Kapre, Bellobradë, Brutë, Zgatar, Krstec, Rapqë, Plavë, Brezne, Lubovisht,Kukalanë, Mlikë, Vraniq, Leshtane (projekt 2 vjeqar) <i>Numri i prokurimit: 621-23-778-5-1-1</i>	500,000.00			2,500,000.00		
2.	Ndërtimi i objektit të qendrës së Mjekësisë familjare në fshatin Krushevë- projekt dy vjeqar <i>Numri i prokurimit: 621-23-725-5-2-1</i>	100,000.00			300,000.00		
3.	Kubëzimi i rrugëve në rrugën Luftëtarët e Lirisë në fshatin Bresanë <i>Numri i prokurimit: 621-23-900-5-2-1</i>	60,000.00			60,000.00		
4.	Ndërtimi I bazenit të ujit në vendin e quajtur Kajqovce në fshatin Libevisht <i>Numri i prokurimit: 621-23-960-5-2-1</i>	15,000.00			15,000.00		
5.	Rregullimi i rrugës dhe infrastrukturës përcjellëse në rrugën Qupino në fshatin Brod <i>Numri i prokurimit: 621-23-921-5-2-1</i>	20,000.00			20,000.00		
KOMUNA E FERIZAJT							
Pesë (5) aktivitetet e para të iniciuara për furnizim gjatë vitit 2023							
Nr.	Titulli i aktivitetit	Planifikimi			Inicimi		
		Sasia	Njësia	Vlera €	Sasia	Njësia	Vlera €
1.	Furnizimi dhe rikonstruimi i rrjetit te ndriqimit publik ne zonat I,II,III dhe IV dhe ne fshatrat Greme,Komogllave,Rahovice,Dardani,Sojev e Kosine <i>Numri i prokurimit: 656-23-404-1-1-1</i>	/	/	980.509,00	25 55 1	m' cope m2	980,509.00
2.	Subvencionimi i fermerëve kultivues të grurit me impute bujqësore- pleh artificial azotik	/	/	100.000,00	150000	kg	100,000.00

⁴² **Sqarim:** Shenja (/) në të gjitha rastet në Aneks I nënkupton se mungon detaji i caktuar.

	Numri i prokurimit: 656-23-981-1-2-1						
3.	Ritenderim Furnizimi i fermerëve me koshere të bletëve Numri i prokurimit: 656-23-969-1-2-1	/	/	40,000.00	330	Copë	40,000.00
4.	Furnizim me material shkollor për shkollat e Komunës së Ferizajt Numri i prokurimit: 656-23-971-1-2-1	/	/	30,000.00	11685 370 340 300 3000	Cope Ris Kmplet Kuti kg	50,000.00
5.	Furnizimi i fermerëve me serra Numri i prokurimit: 656-23-1214-1-1-1	/	/	130,000.00	130	Copë	130,000.00
Pesë (5) aktivitetet e para të iniciuara për shërbime gjatë vitit 2023							
Nr.	Titulli i aktivitetit			Planifikim/Vlera €	Inicim/Vlera €		
1.	Sherbime me erim, skene, ndriqim dhe LED Numri i prokurimit: 656-23-115-2-2-1			60,000.00	60,000.00		
2.	Mbushja e bocave me oksigjen medicinal me sasi 700 kg Numri i prokurimit: 656-23-323-2-3-6			NA	1,600.00		
3.	Transporti i nxënësve nga Fshati Mirashi i Ri - shkollë Numri i prokurimit: 656-23-451-2-2-1			11,000.00	22,000.00		
4.	Mirëmbajtja dhe servisimi i ashensorit në objektin e Komunës së Ferizajt. Numri i prokurimit: 656-23-1173-2-2-1			10,000.00	20,000.00		
5.	Kryerja e shërbimeve të nevojshme për arritjen e objektivave të tatimit në promë- Inpektimi i min, 20% te objekteve dhe kryerja e shërbimeve për inkasim dhe mbledhje të detyrueshme e obligimeve të tatimit në pronë. Numri i prokurimit: 656-23-1572-2-1-1			250,000.00	250,000.00		
Pesë (5) aktivitetet e para për punë të iniciuara gjatë vitit 2023							
Nr.	Titulli i aktivitetit			Planifikim/Vlera €	Inicim/Vlera €		
1.	Rregullimi i infrastrukturës për persona me nevoja të veçanta në rr. Dëshmorët e Kombit; 12 Qershori; V. Gervalla; G.B.SAulejmani; Astrit Bytyqi; Naim Beka. Numri i prokurimit: 656-23-1269-5-2-1			40,000.00	40,000.00		
2.	Ndertimi i salles sportive dhe rregullimi i oborrit ne shkollen Astrit Bytyqi-Ferizaj - faza e dyte Numri i prokurimit: 656-23-1590-5-2-1			N/A	300,000.00		
3.	Ndertimi i nenkalimit per vetura dhe kembesor afer stacionit policor ne Ferizaj Numri i prokurimit: 656-23-2087-5-1-1			7,500,000.00	7,500,000.00		
4.	Ndertimi i objektit II per nevoja te komunes ne fshatin Gerlicë, Ferizaj Numri i prokurimit: 656-23-3448-5-2-1			100,000.00	300,000.00		
5.	Renovimi i shkolles Kemajl Hetëmi ne Rahovicë Numri i prokurimit: 656-23-3684-5-2-1			50,000.00	50,000.00		
KOMUNA E GLOGOCIT							
Pesë (5) aktivitetet e para të iniciuara për furnizim gjatë vitit 2023							
Nr.	Titulli i aktivitetit	Planifikimi			Inicimi		
		Sasia	Njësia	Vlera €	Sasia	Njësia	Vlera €
1.	Furnizim me dosje për personelë dhe material administrativ shëndetësorë Numri i prokurimit: 611-23-496-1-3-6	1,00	Copë	5,500.00	63652 6500	Cope Blok	5,500.00
2.	Furnizim me material shpenzues për stomatologji Numri i prokurimit: 611-23-523-1-2-1	3	Copë	15,000.00	354 2697 9 144 9 18 30 24	Kuti Cope Kg Komplet Kompresë Tube Liter Set	15,000.00
3.	Furnizim me shkumsa per nevojat e shkollave per 24 muaj Numri i prokurimit: 611-23-865-1-2-1	NA	NA	NA	15000 500	Pako Cope	10,000.00
4.	Veturë e ndihmës së shpejtë - Autoambulancë Numri i prokurimit: 611-23-1123-1-2-1	1	Copë	70,000.00	1	Copë	70,000.00

5.	Signalizimi vertikal dhe Horizontal i rrugëve dhe vendbanimeve në Drenas, Komoran, Terstenik, Arllat, Baicë dhe Dobroshec- Projekt dy vjeçar Numri i prokurimit: 611-23-1231-1-2-1	N/A	N/A	N/A	58 3 2	Cope m' m ²	90,000.00
Pesë (5) aktivitetet e para të iniciuara për shërbime gjatë vitit 2023							
Nr.	Titulli i aktivitetit	Planifikim/Vlera €			Inicim/Vlera €		
1.	Mirmbajtja dhe Servisimi i veturave per institucionet e Komunes se Drenasit-36 muaj Numri i prokurimit: 611-23-522-2-2-1	70,000.00			64,200.00		
2.	Vendosja e sistemit te adresave vendosja e tabelave dhe numrave Drenas,Komoran,Nekoc,Arllat,Baice, Terstenik dhe Dobroshec Numri i prokurimit: 611-23-713-2-2-1	5,000.00			15,000.00		
3.	Mirmbajtja dhe servisimi i E-Kioskes Numri i prokurimit: 611-23-1413-2-2-1	20,000.00			20,000.00		
4.	Transporti i nxënësve për arsimin fillor Numri i prokurimit: 611-23-1499-2-2-1	81,600.00			100,000.00		
5.	Shërbime të përfaqësimit në procedura gjyqësore për nevoja të Komunës së Drenasit Numri i prokurimit: 611-23-1507-2-1-1	NA			150,000.00		
Pesë (5) aktivitetet e para për punë të iniciuara gjatë vitit 2023							
Nr.	Titulli i aktivitetit	Planifikim/Vlera €			Inicim/Vlera €		
1.	Asfaltimi i rrugës Llapushnik-Berishë - projekt tre vjeçar Numri i prokurimit: 611-23-1561-5-2-1	70,000.00			350,000.00		
2.	Asfaltimi i rrugës Llapushnik . Poterk , Yukoc . Asfaltimi i rrugës në fshatin Sankoc në fshatin Komoran I.II III dhe asfaltimi i rrugës në fshatin Sankoc , Fushticë e Eperme dhe Ulët - Projekt dy vjeçar Numri i prokurimit: 611-23-2513-5-2-1	240,000.00			417,911.69		
3.	Asfaltimi i rrugës ne fshatin Poklek i Ri , Poklek i Vjeter dhe Vasilevë si dhe Asfaltimi i rrugës në fshatin Dobroshefc dhe Qikatovë e Vjetër - Projekt dy vjeçar Numri i prokurimit: 611-23-3075-5-2-1	140,000.00			354,000.00		
4.	Rregullimi dhe rrethimi i varresave ne Drenas dhe Komoran Numri i prokurimit: 611-23-3425-5-2-1	50,000.00			50,000.00		
5.	Ndërtimi i rrethojës në QMF Komoran dhe pjerrinave në AMF Arllat,Gllanasell,Nekoc dhe Abri Numri i prokurimit: 611-23-3672-5-2-1	30,000.00			30,000.00		
KOMUNA E GJAKOVËS							
Pesë (5) aktivitetet e para të iniciuara për furnizim gjatë vitit 2023							
Nr.	Titulli i aktivitetit	Planifikimi			Inicimi		
		Sasia	Njësia	Vlera €	Sasia	Njësia	Vlera €
1.	Furnizim me material higjienik për shkolla Numri i prokurimit: 632-23-461-1-2-1	N/A	N/A	70,000.00	26420 1300 300	Cope Komplet Pale	46,885.00
2.	Furnizim me autocisternë për njesinë e zjarrfikësave Numri i prokurimit: 632-23-977-1-1-1	N/A	N/A	200,000.00	1	Copë	200,000.00
3.	Furnizim me lule dhe kurora – Kontratë dy vjeçare Numri i prokurimit: 632-23-1666-1-2-1	N/A	N/A	16,500.00	286	Copë	16,000.00
4.	Furnizim me fidane dekorative-Kontratë dy vjeçare Numri i prokurimit: 632-23-2273-1-2-1	N/A	N/A	105,000.00	56	Copë	105,000.00
5.	Furnizimi me material zyrtar për shkolla Numri i prokurimit: 632-23-2228-1-2-1	N/A	N/A	40,000.00	3595 26206 358 65	Pako Cope Kuti Komplet	39,975.60
Pesë (5) aktivitetet e para të iniciuara për shërbime gjatë vitit 2023							
Nr.	Titulli i aktivitetit	Planifikim/Vlera €			Inicim/Vlera €		
1.	Transporti i nxënësve në relacione të ndryshme Numri i prokurimit: 632-23-327-2-1-1	450,000.00			525,000.00		
2.	Sistemi per menaxhimin elektronik te automjeteve – GPS Numri i prokurimit: 632-23-1344-2-2-1	12,000.00			12,000.00		
3.	Servisimi i automjeteve zyrtare-Kontratë dy vjeçare Numri i prokurimit: 632-23-1741-2-2-1	N/A			120,000.00		
4.	Pastrimi dhe larja e veturave zyrtare-Kontratë dy vjeçare	29,100.00			29,100.00		

	Numri i prokurimit: 632-23-1919-2-2-1						
5.	Sigurimi dhe regjistrimi i automjeteve zyrtare Numri i prokurimit: 632-23-1967-2-2-1	32.500,00	20,000.00				
Pesë (5) aktivitetet e para për punë të iniciuara gjatë vitit 2023							
Nr.	Titulli i aktivitetit	Planifikim/Vlera €	Inicim/Vlera €				
1.	Ndërtimi i objektit të banimit social-Faza e dytë Numri i prokurimit: 632-23-1544-5-2-1	300,000.00	300,000.00				
2.	Ndërtimi-asfaltimi i rrugës Kodra e Sukës-Cërmjan Numri i prokurimit: 632-23-1715-5-2-1	250,000.00	219,684.00				
3.	Ndërtimi i anekseve për kalldatore në SHFMU-Ali Hasi & Dëshmorët e Kombit Numri i prokurimit: 632-23-2233-5-2-1	25,000.00	47,945.72				
4.	Sanimi i rrugëve me zhavor Numri i prokurimit: 632-23-2251-5-2-1	50,000.00	50,000.00				
5.	Ndërtimi - asfaltimi i rrugës Qafa e Osekut Numri i prokurimit: 632-23-2174-5-2-1	290,000.00	289,853.57				
KOMUNA E GJILANIT							
Pesë (5) aktivitetet e para të iniciuara për furnizim gjatë vitit 2023							
Nr.	Titulli i aktivitetit	Planifikimi			Inicimi		
		Sasia	Njësia	Vlera €	Sasia	Njësia	Vlera €
1.	Furnizim me material laboratorik Numri i prokurimit: 651-23-215-1-1-1	I	N/A	183,095.00	310828 2400 2835 760 24 60	Cope Kuti Liter Pako kitt l x 1000	126.836.80
2.	Furnizim me material Higjieniko - Sanitar Numri i prokurimit: 651-23-394-1-1-1	I	N/A	65,180.00	50 588 7688 14592 812 311	Cope Rolle Pako Pale Liter	126.836.80
3.	Furnizim me sistemin e kamerave digjitale në QKMF,QMF dhe AMF Numri i prokurimit: 651-23-395-1-3-6	I	N/A	8,000.00	4425	N/A	7,897.00
4.	Furnizim me makina industriale për Pastrimin e Dyshemes Numri i prokurimit: 651-23-427-1-2-1	I	N/A	15,000.00	3	Copë	12,000.00
5.	Furnizim me farë misri Numri i prokurimit: 651-23-811-1-2-1	I	N/A	25,000.00	800	thas	25,000.00
Pesë (5) aktivitetet e para të iniciuara për shërbime gjatë vitit 2023							
Nr.	Titulli i aktivitetit	Planifikim/Vlera €	Inicim/Vlera €				
1.	Instalimi dhe Mirëmbajtja e Ngrohjeve Qendrore Numri i prokurimit: 651-23-2175-2-1-1	38,000.00	161,608.00				
2.	Mirëmbajtja e rrugëve të rendit të tretë me Zhavor Numri i prokurimit: 651-23-2383-2-1-1	160,000.00	480,000.00				
3.	Pastrimi i Lumenjëve dhe prrockave Numri i prokurimit: 651-23-3059-2-2-1	100,000.00	100,000.00				
4.	Ekzaminimi i material ndërtimor dhe shqyrtime gjeomekanike Numri i prokurimit: 651-23-3501-2-2-1	N/A	50,000.00				
5.	Hartimi i projekteve për ndërtime të larta në Komunën e Gjilanit Numri i prokurimit: 651-23-4059-2-1-1	150,000.00	150,000.00				
Pesë (5) aktivitetet e para për punë të iniciuara gjatë vitit 2023							
Nr.	Titulli i aktivitetit	Planifikim/Vlera €	Inicim/Vlera €				
1.	Asfaltimi i rrugëve në qytetin e Gjilanit - Lot I deri në Lot 4 Numri i prokurimit: 651-23-1153-5-1-1	289.196.00	917,856.00				
2.	Rregullimi i Trotuarit dhe ndriçimit Haxhaj-Demiraj Numri i prokurimit: 651-23-1264-5-2-1	119,000.00	179,000.00				
3.	Ndriçimi publik në rrugën e Cërrnicës Numri i prokurimit: 651-23-1553-5-2-1	30.346.00	39,437.68				
4.	Renovimi i Parkut Egzistues afër stadiumit ndihmës të futbollit Numri i prokurimit: 651-23-1266-5-2-1	N/A	33,094.72				
